

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
BILANCI KONTABËL	2
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË	5
SHËNIME TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 15

RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR

Drejtuar: Menaxhimit dhe Ortakeve të Shoqërisë Iliria Development Sh.p.k.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë Iliria Development Sh.p.k. (më poshtë "Shoqëria") që përmbajnë bilancin kontabël më datë 31 Dhjetor 2014 si dhe pasqyrën përkatëse të të ardhurave dhe shpenzimeve për këtë ushtrim, pasqyrën e fluksit të parase dhe pasqyrën e ndryshimeve të kapitaleve të veta, dhe të tjera shënime sqaruese.

Përgjegjësitë e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Kombetare të Kontabilitetit. Kjo përgjegjësi përfshin: përcaktimin, ushtrimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare të cilat nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve; zgjedhjen dhe zbatimin e parimeve të duhura kontabël; dhe kryerjen e çmuarjeve kontabël të arsyeshme për rrethanat financiare.

Përgjegjësitë e Audituesit të Pavarur

Përgjegjësia jone është të shprehim një opinion për pasqyrat financiare duke u bazuar në auditimin e kryer. Ne kryem auditimin tone në pajtim me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin me qëllim që të përfitojmë një siguri të mjaftueshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për shumatat dhe deklarimet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura janë në gjykimin e audituesit, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut të keq-deklarimeve materiale, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve. Gjatë vlerësimit të këtyre rreziqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare të shoqërisë në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat financiare, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë. Një auditim gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve të kontabilitetit e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që ne kemi siguruar janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë.

Opinion

Sipas opinionit tone, pasqyrat financiare të Shoqërisë Iliria Development Sh.p.k japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të gjendjes financiare të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2014 si dhe të rezultateve të aktivitetit të saj për ushtrimin e mbyllur më këtë datë në përputhje me Standartet Kombetare të Kontabilitetit.

Ceshtje të tjera

Pasqyrat financiare të shoqërisë Iliria Development sh.p.k. për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013, kanë qene audituar nga një auditues tjetër, i cili ka shprehur një opinion të pa kualifikuar mbi këto pasqyra në datën 10 Shkurt 2015.

29 Qershor 2015

MAZARS Shpk


Irena Hojha (Pulo)
Partner Angazhimi

 MAZARS
Rr. Emin Duraku, Pall. "Binjaket",
No.5, 1000, Tirana, Albania
phone: +355 42 27 80 15
www.mazars.al . info@mazars.al

ILIRIA DEVELOPMENT SH.P.K.
Pasqyra Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lekë)

Pasqyra e Pozicionit Financiar
Më 31 Dhjetor 2014

	Shenime	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	4	994	8,605
Llogari të arkëtueshme tregtare		-	-
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	5	-	98,168,349
Inventari		-	-
Llogari të tjera të pagueshme	6	220,000	220,000
Total Aktiveve Afatshkurtra		220,994	98,396,954
Aktivë afatgjatë			
Aktivë afatgjatë materiale		-	-
Aktivë në proces	7	1,103,382,792	951,078,079
Llogari të tjera të arkëtueshme		-	-
Total aktive afatgjatë		1,103,382,792	951,078,079
Total Aktive		1,103,603,786	1,049,475,033
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra		-	-
Llogari të pagueshme tregtare	8	1,800	1,800
Detyrime tatimore	9	2,594,239	2,595,421
Llogari të pagueshme të tjera	10	486,841,387	387,402,204
Total Detyrime afatshkurtra		489,437,426	389,999,425
Detyrime afatgjatë			
Hua afatgjatë	11	350,350,000	350,500,000
Total Detyrime afatgjatë		350,350,000	350,500,000
Totali i detyrimeve		839,787,426	740,499,425
Kapitali themeltar			
Kapitali themeltar		493,640,000	493,640,000
Rezerva të tjera		-	-
Rezerva ligjore		-	-
Fitime të mbartura		(184,664,392)	(145,405,170)
Fitimi i ushtrimit		(45,159,248)	(39,259,222)
Total kapitali	12	263,816,360	308,975,608
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		1,103,603,786	1,049,475,033

Andi Ballta
Adminsitator

Artan Dulaku
Administrator

Leonard Bego
Hartuesi



ILIRIA DEVELOPMENT SH.P.K.

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lekë)

**Pasqyra e Te ardhurave dhe Shpenzimeve
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014**


	Shenime	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Te ardhura		-	
Te ardhura te tjera		-	
Materiale te para dhe te konsumueshme		-	
Shpenzime personeli	13	(732,240)	(1,220,000)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi		-	
Shpenzime te tjera	14	(44,745,531)	(35,265,268)
Fitimiooperativ		(45,477,771)	(36,485,268)
Te ardhurat/shpenzime financiare nga njesite e kontrolluara		-	
Teardhura/(Shpenzime) financiare Neto	15	318,523	(2,773,954)
Total shpenzime financiare		318,523	(2,773,954)
Fitimiparatatimit		(45,159,248)	(39,259,222)
Shpenzime tatim fitimi i shtyre		-	
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		-	
Fitimi i vitit		(45,159,248)	(39,259,222)
Te ardhura te tjera te pergjithshme		-	
Totali i te ardhurave te pergjithshme		(45,159,248)	(39,259,222)

Andi Ballta
Adminsitator



Artan Dulaku
Administrator

Leonard Bego
Hartuesi




ILIRIA DEVELOPMENT SH.P.K.
Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lekë)

Pasqyra e Levizjeve të Kapitalit
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

	Kapitali themeltar	Rezerva të tjera	Rezerva ligjore	Fitime të mbartura /humbje të akumuluar	Fitim (Humbje) Ushttrimit	Totali
01 Janar 2013	493,640,000	-	-	(113,948,169)	(31,457,001)	348,234,830
Transferim në rezultatit e mbartur				(31,457,001)	31,457,001	-
Fitimi i vitit					(39,259,222)	(39,259,222)
Dividendët e paguar						-
31 Dhjetor 2013	493,640,000	-	-	(145,405,170)	(39,259,222)	308,975,608
Transferim në rezultatit e mbartur				(39,259,222)	39,259,222	-
Fitimi i vitit					(45,159,248)	(45,159,248)
Dividendët e paguar						-
31 Dhjetor 2014	493,640,000	-	-	(184,664,392)	(45,159,248)	263,816,360

Pasqyra e ndryshimeve në capital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 15, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë Iliria Development sh.p.k. për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014 u aprovuan nga Administratorët e shoqërisë dhe u nënshkruan si më poshtë më 20 Maj 2015 nga:

Andi Ballta

Administrator

Artan Dulaku

Administrator

ILIRIA DEVELOPMENT
shpk
TIRANE - ALBANIA

Leonard Bego

Hartuesi

Pasqyra e Fluksit të Parasëmë 31 Dhjetor 2014

Shenime	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	(45,159,248)	(39,259,222)
Axhustime për zërat jo-monetare:		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	-	-
Fitimi operativ përpara ndryshimeve në kapitalin qarkullues	(45,159,248)	(39,259,222)
<i>Ndryshimi në kapitalin qarkullues</i>		
Ndryshimi në inventar		
Ndryshimi në llogari të arketueshme dhe të tjera	-	521,616
Ndryshimi në llogari të pagueshme dhe të tjera	99,438,001	89,824,756
Ndryshimi në parapagime e shpenzime të shtyra	98,168,349	-
Ndryshimi në të ardhura të shtyra		
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative	152,447,102	51,087,150
Interesat e paguara		
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit		
	-	-
Aktivitetet investuese		
Blerje të aktiveve afatgjata materiale	(152,304,713)	(52,605,000)
Shitje të aktiveve afatgjata materiale		
Interesa të marra		
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues	(152,304,713)	(52,605,000)
Aktivitetet financuese		
(Ripagim)/ të hyrat neto nga huatë agjatgjata	(150,000)	1,525,000
(Ripagim)/ të hyra nga hua afatshkrter		
Shtesa/pakesime në qera financiare		
Dividendë paguar		
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues	(150,000)	1,525,000
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	(7,611)	7,150
Mjetet monetare në fillim të periudhës	8,605	1,455
Mjetet monetare në fund të periudhës	4	8,605

Andi Ballta
Adminisitrator



Artan Dulaku
Administrator



Leonard Bego
Hartuesi



(Vlerat janë në Lekë)

1. TË PËRGJITHSHME

Shoqëria "Iliria Development" shpk është regjistruar në Regjistrin e Shoqërive me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 08.10.2007.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është aktiviteti i blerjes, shitjes, zhvillimit, tregtisë dhe çdo lloj transaksioni në lidhje me pasuri të paluajtshme apo të luajtshme apo të drejta të tjera në lidhura me to, qiraja financiare ose e uzufuktit, apo operimin për llogari të vet apo të tjetërve të pasurive të paluajtshme, si dhe ndertesave të çfarëdo lloji. Te kryejë aktivitete të menaxhimit dhe administrimit, apo të jetë investitor, në ndërtimin e godinave të çdo lloji, të realizojë dënimin me qira të pasurive të luajtshme e të paluajtshme. Te ofrojë konsulence dhe shërbime të tjera për çdo lloj operacionesh menaxhimi apo këshillimi.

Kapitali themeltar i shoqërisë është 493,640,000 leke i cili zotërohet nga ortakët e shoqërisë si më poshtë:

NEP Investment Corp	51%
Artan Dulaku	49%

Administratoret e shoqërisë janë: Z. Artan Dulaku dhe Z. Andi Ballta .

Shoqëria në fund të periudhës ushtrimore ka 2 punonjës.

Shoqëria është e regjistruar pranë degës së Tatimit Taksave Tiranë me NIPT K72208033U.

2. BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE

2.1 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

2.2 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lekë, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.3 Vijueshmeria

Pasqyrat financiare paraqiten sipas parimit të vijueshmerisë, që do të thotë se veprimtaria ekonomike e organizatës do të ketë vijueshmëri, dhe se nuk ka në plan ose nuk do ta ketë të nevojshme ta ndërprejë aktivitetin e saj.

2.4 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrorjës gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken. Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumën e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

3. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat të paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit për dy monedhat e huaja kryesore me monedhën vendase sipas të Bankes së Shqipërisë me 31.12.2013 dhe 31.12.2012 ka qenë respektivisht si më poshtë:

	2014	2013
1 Euro	140,14	140,20
1 USD	115,23	101,86

3.2 Instrumenta financiare

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Paraja dhe ekuivalentët e parasë (Mjete monetare)

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë depozita pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshire koston e transaksioneve.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale. Kuotat klasifikohen si kapitale.

3.3 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën mbi vlerën e mbetur të aktivitetit, për aktivet e blera duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit. Toka nuk amortizohet.

Amortizimi për vitin aktual llogaritet si më poshtë:

Aktive	Përqindja	Menyra
Toka	0%	
Makineri dhe pajisje	20%	
Mobilje dhe orendi	20%	Mbi vlerën e mbetur
Pajisje zyrash dhe informatike	25%	

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.4 Zhvlerësimi

i. Aktivet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktive financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshëm për shitje i njohur me pare ne kapital, transferohet në shpenzime.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.5 Aktive Afatgjata per Investime

Megjense ne Standartet Kombetare te Kontabilitetit nuk ka nje standart per trajtimin e Aktiveve Afatgjata per Investime, per paraqitjen ne Pasqyrat Financiare shoqeria i eshte referuar Standarteve Nderkombetare te Kontabilitetit, SNA 40 - Aktive Afatgjata per Investime.

Aktiv afatgjatë material i investuar është pasuria (toka ose ndërtesa —ose pjesë e ndërtesës —ose të dyja) e mbajtur (nga pronari ose nga qiramarrësi sipas një qiraje financiare) për të siguruar të ardhura nga qiraja ose për rritjen e vlerës së kapitalit apo të dyja, me përjashtim kur:

- a) përdoret për prodhimin ose furnizimin e mallrave, kryerjen e shërbimeve ose për qëllime administrative; ose
- b) shitet në rrjedhën normale të biznesit.

i. Njohja fillestare

Aktivi afatgjatë material i investuar matet fillimisht me koston e tij. Në matjen fillestare do të përfshihen dhe kostot e transaksionit. Kostoja e një aktivi afatgjatë material të investuar të blerë përbëhet nga çmimi i blerjes dhe çfarëdo shpenzimi i ngarkueshëm drejtpërdrejt. Në shpenzimet e ngarkueshme drejtpërdrejt përfshihen tarifatat profesionale për shërbimet ligjore, taksat e transferimit të pasurisë dhe kosto transaksioni të tjera.

ii. Matja e mepasshme

Pas njohjes fillestare, shoqeria ka zgjedhur modelin e koston qe do te thote qe do të matë të gjitha aktivet afatgjata materiale të investuara me kosto.

iii. Kostot e huamarrjes

Kostot e huamarrjes, që janë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e një aktivi të kualifikuar, duhet të kapitalizohen si pjesë e koston së këtij aktivi.

Shuma e kostove të huamarrjes të përshtatshme për kapitalizim përcaktohet në përputhje me standardin nderkombetar te kontabilitetit nr. 23 – *Kostot e huamarrjes*.

Kostot e huamarrjes që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e një aktivi të kualifikuar janë ato kosto huamarrjeje që do të ishin shmangur në qoftë se nuk do të ishte bërë shpenzimi për aktivin e kualifikuar.

Të tjera kosto të huamarrjes njihen si shpenzime në periudhën në të cilën ato kryhen. Shoqeria ka kapitalizuar kostot e huamarrjes ne vleren e aktiveve afatgjata per investim.

(Vlerat janë në Lekë)

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)**3.6 Provizionet**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, kur Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.7 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

3.8 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazen e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejte nëpërmjet llogarisë fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e vitit, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimi i vitit është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë vitit.

4. MJETE MONETARE

Shoqëria ka llogari bankare në leke dhe në valute. Për gjendjet në valute është bërë rivlerësimi me kursin fikse të Bankës së Shqipërisë në dt. 31.12.2014 dhe diferencat janë pasqyruar në rezultatin e shoqërisë. Gjendja e likuiditeteve sipas monedhave me 31.12.2014 paraqitet si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Mjete monetare në banke	994	8,605
Në Leke	2,052	3,575
Në valute të huaj	(1,058)	5,030
Mjete monetare në arke	-	
	994	8,605

5. LLOGARI TË ARKËTUESHME

Ne kete ze eshte paraqitur teprica kreditore e tatim fitimit si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Tatim mbi fitimin	220,000	220,000
	<u>220,000</u>	<u>220,000</u>

6. PARAPAGIME DHE SHPENZIME TE SHTYRA

Ne kete ze eshte paraqitur paradhenia per blerje toke gjendja e te ciles ne 31 Dhjetor 2013 paraqitet si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Paradhenie per blerje toke	-	98,168,349
	<u>-</u>	<u>98,168,349</u>

7. AKTIVE AFATGJATA PER INVESTIM

Ne kete ze jane paraqitur investime per blerje toke tek e cila shoqeria ka ne plan investimin.

Aktivet afatgjata per investime jane paraqitur me kosto me 31 Dhjetor 2014. Per investimet eshte e veshtire te behet vleresimi me vleren e drejte pasi eshte e veshtire gjetja e pronave te ngjashme per te bere krahasim ku faza e investimit si edhe qellimi final jane te ngjashme dhe ku mund te thuhet me siguri se vlera aktuale a flukseve te ardhshme te parase nga keto investime reflekton edhe ate qe mund te pritret nga investimi i shoqerise.

Shoqeria ka kapitalizuar gjate vitit 2014 interesa ne shumen rreth 54 milion leke.

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Aktive Afatgjata per Investim	1,103,382,792	951,078,079
	<u>1,103,382,792</u>	<u>951,078,079</u>

8. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet e palikujduara ndaj furnitorëve. Më poshtë janë paraqitur këto detyrime më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Te pagueshme ndaj furnitoreve	1,800	1,800
	<u>1,800</u>	<u>1,800</u>

9. DETYRIME TATIMORE

Detyrimet tatimore më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Detyrime per sigurimet shoqerore dhe shendetesore	2,040	-
Tatim ne burim	2,592,199	2,595,421
	<u>2,594,239</u>	<u>2,595,421</u>

10. LLOGARI TE PAGUESHME TE TJERA

Ne kete ze jane perfshire detyrimet ndaj ortakeve, ndaj punonjesve dhe interesat e perllogaritura, te cilat jane detyrime per interesat dhe penalitet per huane e marre ndaj ortakut NEP Investment Corp.

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Te pagueshme ndaj punonjesve	1,559,760	852,000
Detyrime ndaj ortakeve	43,860	-
Debitore te tjere	37,501	-
Interesa te perllogaritura	485,200,266	386,550,204
	<u>486,841,387</u>	<u>387,402,204</u>

11. HUAMARRJE AFATGJATE

Huaja afatgjate me 31 Dhjetor 2014 paraqitet si me poshte:

	<u>Më 31 Dhjetor 2014</u>	<u>Më 31 Dhjetor 2013</u>
Hua	350,350,000	350,500,000
Totali	<u>350,350,000</u>	<u>350,500,000</u>

12. KAPITALI THEMELTAR**Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerë 493,640,000 Lekë.

Fitime/Humbje te mbartura

Shuma prej (184,664,392) Lekë përfaqëson humbjet e mbartura nga periudhat e kaluara.

Fitimi/Humbja i/e ushtrimit

Shuma prej (45,159,248) Lekë përfaqëson humbjen e vitit të mbyllur më 31 Dhjetor 2014.

(Vlerat janë në Lekë)

13. SHPENZIMET E PERSONELIT

Ne kete ze jane paraqitur shpenzime per paga te personelit si me poshte.

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013</u>
Pagat e personelit	720,000	1,220,000
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	12,240	-
Totali	<u>732,240</u>	<u>1,220,000</u>

14. SHPENZIME TË TJERA

Këto shpenzime janë analizuar në tabelën e mëposhtme:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013</u>
Shpenzime te ndryshme	-	18,000
Penalitete per interesa te papaguar	44,679,128	35,406,281
Shpenzime hipoteke	43,860	-
Taksa dhe tarifa vendore	-	25,120
Sherbime bankare	22,543	15,317
Shpenzime te tjera konsulence	-	(199,450)
Totali	<u>44,745,531</u>	<u>35,265,268</u>

15. TË ARDHURA DHE SHPENZIME FINANCIARE

Te ardhurat dhe shpenzimet financiare jane analizuar si me poshte:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013</u>
Shpenzime per interesa	(17)	
Humbje nga kembimet valutore	(93,087)	(2,773,925)
Te ardhura nga kembimet valutore	411,627	
Shpenzime te tjera financiare		(29)
Totali	<u>318,523</u>	<u>(2,773,954)</u>

16. TATIMI MBI FITIMIN

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri, norma e të cilit është 15% (2013: 10%). Formularët e deklarimit të tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet të deklaruara për qëllime të tatueshme konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që janë vëzhguar dhe vlerësuar nga autoritetet tatimore.

Legjislacioni tatimor dhe ligjet Shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
Fitim i vitit përpara tatimit	(45,159,248)	(39,259,222)
Humbje e mbartur	(7,982,713)	(4,129,772)
Shpenzime të pazbritshme si me poshte::	44,679,128	35,406,281
<i>Penalite per interesa te papaguara</i>	<i>44,679,128</i>	<i>35,406,281</i>
Fitimi fiskal para tatimit	(8,462,833)	(7,982,713)
Tatimi mbi fitimin		-

17. TRANSAKSIONET ME PALET E LIDHURA

Bilanci Kontabel

	Më 31 Dhjetor 2014	Më 31 Dhjetor 2013
Hua NEP Investment Corp.	350,500,000	350,500,000
Intersa te perllogaritura –NEP Investment Corp	485,200,266	386,550,204
Total	835,700,266	737,050,204

Transaksione gjate periudhes

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013
NEP Investment Corp. (Interes)	54,136,362	52,605,000
NEP Investment Corp. (Penalite)	44,679,128	35,406,281
	98,815,490	88,011,281

(Vlerat janë në Lekë)

18. ANGAZHIME DHE PASIGURI

Çeshtje gjyqesore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2014 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqesore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të ketyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

19. NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT

Me 2 prill 2015, shoqëria nënshkroi një kontratë huaje me NEP Investment Corp. për ristrukturimin e kontratës së huasë për vlerën prej 3.3 milion EUR.

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.